



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Nr.Regj.Themeltar 942  
Nr.Vendimit 942

Datë Rregj.05.12.2011  
Datë Vend.22.12.2011

V E N D I M  
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË  
PREJ :

**KRYETARI SEANCËS GJYQËSORE ---- REXHEP BEKTESHI**

Me sekretare **Liliana Shahu**, sot më datë 22.12.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen penale Nr.942 datë 05.12.2011 me:

**KËRKUES:** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës.

**OBJEKTI:** Vendosjen e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” mbi sendin Bar-Restorant-Hotel 5 kat, i ndodhur në lagjen Nr.13 Plazh-Durrës dhe i rregjistruar në Zonën Kadastrale 8518,me rregjistër hipotekor Nr.24 datë 08.02.2002 në emër të shtetases  
për shkak se dyshohet si produkt i veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”,që parashikohet nga neni 287 të K.Penal në ngarkim të pandehurit /

**Baza Ligjore:** Neni 274 të K.Pr.Penale.

U thirr dhe u paraqit në gjykim prokurori i çështjes **Afrim Shheu** që në përfundim të shqyrtimit gjyqësor,i kërkoi gjykatës:

Pranimin e kërkesës së bërë dhe vendosjen e masës së sigurimit pasuror,”Sekuestro Preventive” mbi objektin, Bar-Restorant-Hotel 5 katësh, i ndodhur në lagjen Nr.13 Plazh-Durrës dhe i regjistruar në Zonën Kadastrale 8518,Rregjistër Hipotelor Nr.24 datë 08.02.2002 në emër të shtetases  
për shkak se dyshohet si produkt i veprës

penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale", që parashikohet nga neni 287 të K.Penal, në ngarkim të pandehurit A

Gjykata pasi shqyrtoi materialet e çështjes,

### V Ë R E N

Se mbi bazën e materialeve të paraqitura nga Drejtoria Kundër Krimin Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është rregjistruar procedimi penal Nr.255 datë 24.02.2009 ( i rifilluar më datë 22.02.2011) për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale", që parashikohet nga neni 287 të K.Penal, në ngarkim të shtetasit A, që është marrë i pandehur për këtë veprë penale më datë 12.11.2011.

Nga hetimet e kryera del se i pandehuri A në vitin 1998 ka qënë në procedim penal bashkë me disa shtetas të tjerë shqiptar nga Prokuroria e Xhenovas-Itali dhe i akuzuar për disa vepra penale si, trafikim femrsh, shfrytëzim prostitucioni, shitje lënde narkotike etj.

Ky fakt është konfirmuar edhe me shkresën Nr.889/2 PE17/2009 datë 06.06.2009 të Interpol Tirana ku personi nën hetim, **rezulton në kërkim ndërkombëtar**, për llogari të shtetit italian, pasi nga Gjykata e Genovës, ishte lëshuar urdhëri i arrestit Nr.22182/00R.G.N.R/1617/01 R.G.G.I.P, datë 18.03.2002, **në bazë të cilit personi nën hetim është dënuar me 24 vjet burgim**, për veprat penale të pjesmarrjes në organizata kriminale, trafik droge dhe shfrytëzim prostitucioni.

Organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës ka kryer hetime dhe janë evidentuar disa pasurive të paligjshme, të regjistruara në emër të tij dhe të afërmeve të tij në Zyrën Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Palujtëshme Durrës.

Gjithashtu në Zyrën e Urbanistikës të Bashkisë Durrës janë administruar kopje të dokumentacionit të një hoteli të emërtuar "Iliria Internacional", që ndodhet në Lagjen Nr.13-Plazh-Durrës dhe i regjistruar në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurisë së Palujtëshme Durrës, në emër të

Kapçiu, që është nëna e të pandehurit ... .Ai ka aktivitet Restorant-Motel.

Sipas dokumentacionit të grumbulluar në hetim del se subjekti i mësipërm, nuk ka dorëzuar asnjë bilanc gjatë viteve të ushtrimit të veprimtarisë dhe organet kompetente, kanë përcaktuar vlerën e tatimit të thjeshtuar për vitet 2003-2009.

Gjithashtu rezulton se më datë 30.10.2004, subjekti i mësipërm ka bërë mbyllje provizore të aktivitetit dhe për vitin 2006, ka 63.046 lekë detyrim si diferencë të papaguar, për vitin 2007 ka 20.000 lekë gjobë për mosnjofitim ndryshimesh dhe për vitin 2009, ka 58.229 lekë si diferencë të pa paguar.

Organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës në hetim ka administruar vendimin penal Nr.2003/0924 rregjistri datë 29.10.2003 të Gjykatës së Apelit të Bolonjës, nga ku del se i pandehuri është dënuar me 9 vjet e 4 muaj heqje lirie e 28.000 Euro gjobë, për shitje lëndëve narkotike etj.KY vendim penal ka marrë formë të prerë më datë 14.12.2003.

Gjithashtu është administruar një dëshmi penaliteti për të dënuarin nga autoritet e drejtësisë italiane për aktivitetin e paligjshëm të kryer në periudhën Janar 2001 deri më datë 21.08.2011 në Bolonja-Itali, për veprën penale të "Krijimit,drejimit ose financimit të një shoqate kriminale të marrë me trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike".Për këtë veprë penale, ai është dënuar me 9 vjet e 4 muaj heqje lirie e 28.000 Euro gjobë.

Nga materialet e letër porosisë të adminsitruar dhe letërkëmbimit të Interpolit Shqiptar e atij Italian,ka rezultuar se i pandehuri që banon në lagjen Nr.13 Plazh-Durrës ka dhe dreiton në Plazhin e Durrësit, Hotel-Restorant 5 katësh i emërtuar ...

Në hetim pranë Z,V.R.P.P.-Durrës,Qëndrës Kombëtare të Rregjistrimit Tiranë,Drjtorisë së Tatim-Taksave Durrës etj, janë kërkuar të dhëna për pasuritë e regjistruara në emër të pandehurit e të afërmëve të tij,që janë vënë në mënyrë të paligjshme nga aktiviteti kriminal i kryer prej tij në Itali dhe për hetimin e veprës penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale",që parashikoht nga neni 287 i K.Penal.

Pas administrimit të të dhënave nga këto institucione është caktuar ekspertimi teknik-kontabël dhe ekspertit kontabël i është kërkuar të përcaktonte nëse nga të ardhurat e ligjshme të realizuar nga i pandehuri e familjarët e tij, mund të realizoheshin shpenzimet për blerjen e pasurive si dhe të ndërtimit e vënien në funksionim të "Hotel Iliria Internacional" 5 katësh, që ndodhet e administrohet nga nëna e të pandehurit, e quajtura , në lagjen Nr.13 Plazh-Durrës.

Ky objekt është rregjistruar në Z.R.P.P-Durrës në regjistrin Hipotekor Nr.24 datë 08.02.2002, Zona Kadastrale 8518 me Nr.pasurije 44/66 vol.11 faqe 40.

Akti i ekspertimit teknik-kontabël i ekspertes i datës 16.11.2011, ka përcaktuar që i pandehuri e familjarët e tij, **kanë kryer shpenzime të mëdha që nuk justifikohen nga aktiviteti i tyre i ligjshëm.**

Nga materialet e çështjes del se ka të dhëna, fakte e prova, që tregojnë se objekt Bar-Restorant-Hotel 5 katësh, i emërtuar "Hotel Iliria Internacional", që ndodhet në Lagjen Nr.13 Plazh-Durrës, i regjistruar në Z.R.P.P-Durrës në emër të shtetases Vaje Kapçiu ( nëna e të pandehurit ) është ndërtuar nga përfitimet e paligjshme të siguruara nga aktiviteti i kundërligjshëm i të pandehurit , që akuzohet nga organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale", që parashikohet nga neni 287 të K.Penal.

Organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës ka kërkuar nga gjykata, vendosjen e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro preventive", mbi objektin Bar-Restorant 5 katësh, i emërtuar "Hotel Iliria Internacional", që ndodhet në lagjen Nr.13 Plazh-Durrës, i rregjistruar në Zonën Kadastrale 8518, me rregjistër hipotekor Nr.24 datë 08.02.2002, në emër të shtetases , pasi dyshohet se është produkt i veprës penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale", që parashikohet nga neni 287 i K.Penal në ngarkim të pandehurit

Kjo masë sigurimi pasurore kërkohet pasi ekziston rreziku që objekti i mësipërm, të shitet nga i pandehuri apo

familjarët e tij,apo të ndryshojë destinacion,duke ndikuar në pasojat që lidhen me veprën penale në ngarkim të pandehurit.


Gjykata pasi analizoi provat e faktet,konkludon që kërkesa e bërë nga organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës duhet pranuar, pasi ekziston rreziku që objekti Bar-Restrorant 5 katësh, i emërtuar "Hotel Ilia Internacional", që ndodhet në lagjen Nr.13 Plazh,në emër të nënës së të pandehurit,shtetases [blank], të shitet apo të kryhen veprime të tjera gjatë fazës së hetimeve paraprake.Gjykata vleron se ky objekt,ka lidhje me veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale",që parashikohet nga neni 287 të K.Penal,në ngarkim të pandehurit Arjan Kapo.

**PËR KËTO ARSYE**

Në zbatim të neneve 274 e 276 të K.Pr.Penale,gjykata

**V E N D O S I**

- **Pranimin e kërkesës** së Organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe vendosjen (caktimin), e masës sigurimit pasuror "Sekuestro Preventive", mbi objektin Bar-Restorant hotel 5 kate,i emërtuar [blank],që ndodhet në lagjen Nr.13 Plazh-Durrës dhe i regjistruar në Z.R.P.P-Durrës,në emër të shtetases [blank],në regjistrin Hipotekor Nr.24 datë 08.02.2002,Zona Kadastrale 8518 me Nr.Pasurie 44/66 vol.11 faqe 40.
- Një kopje e këtij vendimi i dërgohet organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprim.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, brënda 10 ditëve nga shpallja e tij,ose nga dita e marrjes dijeni.
- U shpall më datë 22.12.2011.



**G J Y Q T A R I**

**/ REXHEP BEKTESHI/**